

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE, MALIT TË ZI, PËRFAQËSUAR NGA ZYRA E INTEGRIMIT EVROPIAN, DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MALI I ZI-SHQIPËRI 2014-2020, ALOKIMET PËR VITIN 2020”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Malit të Zi, përfaqësuar nga Zyra e Integrimit Evropian, dhe Komisionit Evropian, për Programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020. Programi IPA Bashkëpunimi Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020, u miratua nga Komisioni me Vendimin Zbatues C(2014) 9674, të datës 11 dhjetor 2014. Alokimet e vitit 2020 për këtë program financohen nga një grant i Bashkimit Evropian nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 1 530 000 eurosh për të dyja vendet por duke marrë parasysh edhe bashkëfinancimin kombëtar të dy shteteve buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2020, arrin vlerën e 1 800 000 euro.

Marrëveshja e financimit është miratuar, në parim, nga ana e Këshillit të Ministrave, nëpërmjet vendimit nr.593, datë 15.10.2021, “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Malit të Zi përfaqësuar nga Zyra e Integrimit Evropian dhe Komisionit Evropian, për Programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020, alokimet për vitin 2020.

Sqarojmë se në total, kontributi i Bashkimit Evropian për zbatimin e përbashkët të Programit Mali i Zi-Shqipëri për periudhën 2014-2020 arrin vlerën e 11 900 000 euro. Sjellim në vëmendje se, gjashtë marrëveshje të tjera financimi janë konkluduar mes palëve për të njëjtin program (për alokimet e viteve 2014, 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019), të cilat janë ratifikuar edhe nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (ligji nr.31/2016, ligji nr.78/2018, ligji nr.21/2019, ligji nr.38/2020 dhe ligji nr.158/2020).

Përfitues të këtij programi do të jenë zonat, si më poshtë:

Në Mal të Zi: Andrijevica, Berane, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë, Podgoricë, Cetinje, Danilovgrad, Budva, Bar dhe Ulqin.

Në Shqipëri: Qarku Shkodër, Qarku Lezhë, Bashkia Tropojë.

Programi i Bashkëpunimit Mali i Zi-Shqipëri ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin midis të dyja vendeve nëpërmjet veprimeve të përbashkëta. Ky program mbështet, gjithashtu, shkëmbimin e eksperiencës dhe njohurive midis përfituesve si dhe përmirësimin e politikave publike mes autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit. Programi në fjalë mbulon një territor prej 11 970 km² me një popullsi prej rreth 749 257 banorë.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike si:

1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut;
3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit.

Një tjetër aks prioritar do t'i dedikohet asistencës teknike prej rreth 1 190 000 euro për të gjithë periudhën e zbatimit 2014-2020, për të dyja vendet, duke përbërë 10% të buxhetit të përgjithshëm të programit. Kjo asistencë do të përdoret kryesisht për zbatimin efektiv, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e strukturave kombëtare dhe atyre teknike.

Marrëveshja e financimit për këtë program përbëhet nga 8 pjesë:

1. Kushtet e veçanta;
2. Shtojca I: Programi i Veprimit CBC Mali i Zi - Shqipëri për vitet 2018-2020;
3. Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014-2020 ndërmjet Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë;
4. Shtojca II: Kushtet e përgjithshme;

5. Shtojca III: Model i Raportit Vjetor BNK për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenin 80, të marrëveshjes kuadër;
6. Shtojca IIIA: Modeli i Raportit Vjetor për zbatimin e asistencës IPA II në përputhje me nenet 58 dhe 59(1) të marrëveshjes kuadër;
7. Shtojca IV: Modeli i Raportit Financiar sipas nenit 59(2) të marrëveshjes kuadër;
8. Shtojca V: Specifikimet Minimale të Sistemit të Kontabilitetit me Bazë Akruale;

Programi i Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri për vitet 2018-2020 (Shtojca I) përmban një përshkrim të modaliteteve të zbatimit të programit, përfshirë alokimet për secilin vit financiar, prioritetet e programit, kushtet e thirrjeve për projektpropozime dhe monitorimin e performancës së programit.

Programi i Bashkëpunimit (Shtojca IA) përmban një analizë të karakteristikave kryesore të territorit të lejueshëm, prioriteteve dhe ofron një pasqyrë të sfidave të zhvillimit që rrethojnë zonën e Programit, të cilat mund të trajtohen nëpërmjet projekteve të përbashkëta.

Një pjesë e rëndësishme e marrëveshjes janë edhe Kushtet e Përgjithshme (shtojca II), ku parashikohen përgjegjësitë dhe strukturat zbatuese të Programit. Ky program do të zbatohet me menaxhim indirekt nga Mali i Zi dhe autoriteti kontraktues do të jetë Drejtoria e Financave dhe Administrimit të Fondeve të Ndihmës së BE-së (CFCU) në Ministrinë e Financave të Malit të Zi.

Shtojcat III, IIIA dhe IV të marrëveshjes paraqesin modelet e raportit vjetor të zbatimit për secilin program të bashkëpunimit ndërkufitar përfshirë dhe një raport të përbashkët për të gjitha programet e bashkëpunimit ndërkufitar që përfiton vendi ynë, pavarësisht zbatimit nën menaxhimin indirekt apo direkt nga ana e Komisionit Evropian.

Shtojca V parashikon kushtet që përfituesi IPA II duhet të plotësojë për ngritjen e sistemit të kontabilitetit, me bazë akruale.

Mali i Zi dhe Shqipëria do të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin për koordinimin, menaxhimin dhe monitorimin e zbatimit të programit. Struktura institucionale e Programit është e përbërë nga autoriteti kontraktues i programit (Mali i Zi), Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, Sekretariati i Përbashkët

Teknik si dhe Koordinatorët Kombëtarë të fondeve IPA të dyja vendeve përfituese.

Nga alokimet e mëparshme financiare të këtij programi janë shpallur dy thirrje për projekt propozime:

- Thirrja e parë u lançua në periudhën korrik – shtator 2016 dhe u konkludua me 8 (tetë) projekte fituese.
- Thirrja e dytë u lançua në periudhën shkurt – maj 2019 dhe aplikimet e kryera janë në proces vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit.
Për alokimet e vitit 2020, të cilat janë subjekt i marrëveshjes financiare në fjalë, do të vihen në dispozicion për thirrjen e tretë për projektpropozime, e cila u hap në qershor 2021 dhe qëndroi e hapur deri në shtator 2021. Deri tani nuk kemi fitues pasi në nëntor 2021 do të nisë procesi i vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektakti është parashikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i kësaj marrëveshjeje financiare do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi sipas prioriteteve të përcaktuara në program, duke iu mundësuar në këtë mënyrë aktorëve rajonalë dhe vendorë nga të dyja vendet të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme dhe një efekt të matshëm për sektorin socio-ekonomik.

Programi i bashkëpunimit Mali i Zi-Shqipëri ka reflektuar rëndësinë që BE-ja i kushton çështjeve horizontale dhe ndërsektoriale. Çështje të tilla janë reflektuar në të gjitha prioritetet e zgjedhura për programin, si krijimi i partneriteteve ndërkufitare, “autorësia” vendore dhe mundësitë e barabarta, garantimi i mosdiskriminimit të minoriteteve dhe të kategorive të cënueshme, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore etj. Programi është në përputhje të plotë me Strategjinë e BE-së për Rajonin e

Adriatikut dhe Jonit dhe të dyja vendet mund të zbatojnë projekte strategjike të përbashkëta në kuadër të strategjisë makro-rajonale në të cilën bëjnë pjesë.

Në lidhje me evidentimin e problematikave, ashtu si në çdo program tjetër të bashkëpunimit ndërkufitar, problematika kryesore pas miratimit të projektvendimit, do të lidhet kryesisht me mundësitë dhe kapacitetet e përfituesve shqiptarë për përthithjen, hartimin e projektpropozimeve dhe zbatimin me sukses të projekteve të financuar nga ky program. Ndaj në vazhdim, puna e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme do të fokusohet në mbështetjen e përfituesve shqiptarë për hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të projekteve. Në këtë kontekst, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, gjatë thirrjeve për projektpropozime zhvillon trajnime dhe ditë informuese të ndryshme në të gjitha zonat e lejuara të programit, duke ftuar palët e interesuara, e duke bërë publike procesin e tyre. Në këto ditë informuese, jepen informacione të nevojshme mbi hartimin e projektpropozimeve, krijimi i partneriteteve të ndryshme, afatet dhe të gjitha detajet e tjera të lidhura me udhëzuesit për aplikantët, të cilat afishohen publikisht në faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën edhe Punët e Jashtme, delegacioneve të Bashkimit Evropian të vendeve përkatëse të këtij programi e gjithashtu dhe në Institucionet përgjegjëse në Malin e Zi.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr.37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)”.

Pas miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave, marrëveshja i nënshtrohet ratifikimit me ligj nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, bazuar edhe në pikën 1, të nenit 121, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektakt nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Malit të Zi, përfaqësuar nga Zyra e Integritit Evropian dhe Komisionit Evropian, për Programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Mali i Zi-Shqipërisë 2014-2020, alokimet për vitin 2020, me një vlerë prej 1 530 000 eurosh për të dyja vendet. Ky buxhet do të përdoret për financimin e projekteve sipas akseve prioritare të këtij programi. Projektet përzgjidhen pas një procesi transparent aplikimi.

Gjithashtu, nënvizojmë se në rastin e hapjeve të thirrjeve për projektpropozime MEPJ-ja e shpall atë në internet dhe organizon ditë informuese në zonat e lejueshme të Programit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij akti.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në lidhje me zbatimin e ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, theksojmë se Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka marrë iniciativën për konsultimin publik të përmbajtjes së Programit duke bërë publike në faqen zyrtare të ish-Ministrisë së Integritit Evropian, të gjitha dokumentet apo edhe draftdokumentet, për të cilat është gjykuar se mund të ketë interes publik. Procesi i përgatitjes dhe konsultimit të programit filloi në korrik të vitit 2013, duke vazhduar deri në maj 2014, kur edhe u dërgua drafti final për miratim nga ana e Komisionit Evropian.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ende nuk mund të shprehemi saktësisht në lidhje me efektet konkrete financiare në buxhet, por duke marrë parasysh se përfitimi financiar i të dyja vendeve do të jetë përafërsisht i barabartë. Pritet që vendi ynë të përfitojë shumë prej rreth 750 000 euro nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje. Theksojmë se, përfitues të këtij programi nuk do të jenë vetëm institucionet shtetërore buxhetore por edhe

organizata e shoqata të tjera jofitimprurëse (të cilat nuk ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore). Sjellim në vëmendje se raporti i financimit të çdo projekti të financuar nga kjo marrëveshje (përveç projektit të asistencës teknike) është në raportin 85% grant i BE-së dhe 15% bashkëfinancim kombëtar.

KËSHILLI I MINISTRAVE